



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 26.06.2025

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, në pajtim me dispozitave e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, si dhe në harmoni me nenin 37 të Udhëzimit Administrativ MMPH – NR.24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Komisioni për Përrjashtimet thërret:

TAKIM PUBLIK

Komisioni për Përrjashtimet mbi kërkesat për Kushte ndërtimore /Leje ndërtimore, organizon Takim Dëgjimorë të hapur dhe publik me qytetarët e interesuar për trajtimin e kërkesave / parashtrësive për përrjashtime në zonat si:

- Zona veri perëndimore e zonës urbane në Komunën e Gjakovës parcela kadastrale ndërtimore me numër P-70705028-04373-4 Z.K. Gjakovë jashtë qytet , aplikuesi Qaush Jakupaj;

Qëllimi i dëgjimit publik është shqyrtimi i propozimeve për përrjashtime për Kushte ndërtimi dhe lejime realizimit të Lejes ndërtimore sipas dokumentit paraprak urbanistik, në lokacionin të cilin e gjeni të bashkëngjitur me këtë Njoftim Publik.

Lokacioni për ndërtimin e objektit të banimit sipas destinimit të përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor si Harta Zonale e Komunës 2024-2032 dhe kërkesa për përrjashtim që i referohet mundësimin të shfrytëzimit dhe zhvillimit të parcelës sipas Zgjidhjes paraprake urbanistike (pala disponon Leje ndërtimi dhe është i vetmi i pa realizuar nga Zgjidhja urbane) pa përmbushur kushtin e sipërfaqes minimale prej 6.0ari/600.0 m², sepse kompleksi – zgjidhja urbanistike ku përfshihet parcela është realizuar, parcela rrethohet në anën veriore me rrugë ekzistuese ndërsa në anën lindore me rrugë të planifikuar dhe nuk ka mundësi tjetër zhvillimi.

- **PËRRJASHTIMI I REFEEROHET REALIZIMIT DHE PËRMBYLLJES SË ZGJIDHJES PARAPRAKE URBANE (PER TE CILËN DISPONOHET ME LEJE NDËRTIMI)**

Takimi Dëgjimorë dhe Publik me qytetarët e interesuar do të mbahet me datën 04.07.2025 (e premtë) , në orën 10⁰⁰ në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Kopjet fizike të këtyre dokumenteve mund të tërhiqen në objektin e Administratës të Komunës së Gjakovës, rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë çdo ditë pune prej orës **10⁰⁰ deri në orën 14⁰⁰**, duke filluar nga data 27.06.2025 deri në ditën e organizimit të takimit publik me datë 04.07.2025, pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Kryesuesja e Komisionit

Elida Bejtullahu

Parc. nr.4373-4